



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 664/Prot.
2

Tiranë, më 09.07. 2015

Lënda : Në lidhje me kërkesën për interpretim dhe njoftimin mbi fillimin e një përpunimi të ri të të dhënave personale.

Drejtuar: **KRYEMINISTRISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Z. Engjëll AGAÇI
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Tiranë

I nderuar Z. Agaçi,

Fillimisht, Zyra e Komisionerit e vlerëson angazhimin Tuaj në kuadër të respektimit të legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ju informon se ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj për interpretim lidhur me përpunimin e të dhënave në kuadër të funksionimit të “Bibliotekës Dixhitale të Kryeministrisë”, si dhe njoftimin në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, për fillimin e një përpunimi të ri të të dhënave personale.

Në vijim do të gjeni argumentet ligjorë përkatës mbi përpunimin e të dhënave në kuadër të funksionimit të Bibliotekës Dixhitale:

Në bazë të nenit 4 “Fusha e zbatimit”, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, parashikohet se ligji në fjalë nuk zbatohet në rastet kur jepet informacion për persona publikë zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre.

Kjo nënkupton se në rastet e shkresave zyrtare administrative nuk aplikohet ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Por duhet të keni parasysh që ligji zbatohet për rastet kur kemi të bëjmë me të dhëna personale të personave të thjeshtë që nuk ushtrojnë funksione publike zyrtare apo

funksiione në administratë. Në këto raste, duhet të garantohen të drejtat e tyre për privatësi. (Ligji për mbrojtjen e të dhënave gjen zbatim vetëm për personat e gjallë).

Ligji i sipërcituar aplikohet vetëm për të dhënat e personave fizikë dhe në rastin tuaj për personat që kanë kryer funksione publike. Nëse publikohen të dhëna për personat juridikë nuk ka pengesë ligjore.

Gjithashtu, të dhënat që publikohen duhet që të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë atë. Kjo nënkupton faktin se nuk duhet të publikohen më tepër të dhëna se sa nevojiten për arritjen e qëllimit. Pra, çdo dokument përpara publikimit duhet të kontrollohet në kuadër të përmbushjes dhe respektimit të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale (neni 5).

Sa i përket dokumenteve të vjetra arkivore (referuar nga ana juaj) të cilat kanë vlera historike, kur nuk ka pengesa strikte ligjore (psh., ligji për arkivat ose ligji për sekretin shtetëror), përpunimi legjitimohet por, gjithmonë duke respektuar parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, neni 5 dhe 6 i ligjit. Nëse informacioni që do publikohet merret nga regjistër i hapur për publikun nuk ka kufizime ligjore.

Sa i përket, zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", vlerësojmë si mjaft të rëndësishëm detyrimin që, çdo institucion publik ashtu si dhe Ju, keni për të konsultuar rastet e kufizimeve të së drejtës për informim (parashikuar në nenin 17). Ky vlerësim duhet të bëhet rast pas rasti përpara publikimit të dokumentit dhe duke bërë balancën e duhur midis interesit publik dhe mbrojtjes së privatësisë.

Në lidhje me njoftimin Tuaj, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 9887 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, për fillimin e një përpunimi të ri të të dhënave personale, Ju informojmë se për ndryshimin e gjëndjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të nenit të mësipërm, paraprakisht duhet plotësuar detyrimi për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale për të cilin subjekti kontrollues publik "Kryeministria e Republikës së Shqipërisë", është përgjegjës.

Ky detyrim realizohet duke plotësuar Formularin e Njoftimit në dy mënyra:

1. Mënyra "*online*", plotësohet elektronikisht prej subjektit kontrollues në Faqen Zyrtare të Komisionerit, duke plotësuar çdo rubrikë të tij sipas pyetjeve të parashtruara;
2. Mënyra "*manuale*", nëpërmjet printimit të "*Formularit të Njoftimit*", plotësimi të rubrikave përkatëse dhe dërgimin e tij pranë zyrës së Komisionerit nëpërmjet postës ose dorazi.

Pasi të ketë përfunduar procesi i njoftimit të Komisionerit, në lidhje me të dhënat që përpunoni gjatë ushtrimit të veprimtarisë Tuaj, për çdo ndryshim në qëllimin apo qëllimet e përpunimit, si dhe në përmbajtjen e njoftimit të mëparshëm, çdo subjekt kontrollues i regjistruar duhet të njoftojë sërish zyrën e Komisionerit. Pra nëse kontrolluesi i regjistruar më parë ka vendosur të

realizojë një përpunim të ri të të dhënave personale, ose ka ndryshuar gjendjen e mëparshme të përpunimit të njoftuar, atëherë ai duhet të njoftojë sërish Zyrën e Komisionerit.

Njoftimi për një përpunim të ri si dhe ndryshimet në njoftimin e mëparshëm realizohet duke plotësuar online Deklaratë Ndryshimi, duke plotësuar Formularin e Njoftimit manualisht vetëm në rubrikat ku ka ndryshim ose duke ju drejtuar Zyrës me anën e një shkrese ku shpjegohen ndryshimet ose përpunimi i ri.

Megjithatë, për sqarime të mëtejshme, në lidhje me këtë detyrim ligjor si dhe për çdo asistencë në plotësimin e formularit të njoftimit, manualisht ose online në faqen zyrtare të Komisionerit mbetemi në dispozicionin tuaj.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI


KOMISIONERI
